



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 5791 Prot.

Shkodër, më 13 / 04 / 2022

URDHËR

Nr. 288 Datë 13 / 04 / 2022

**“Mbi marrjen e masave paraprake për shërbimin e pastrimit në zonën turistike të Bashkisë Shkodër zona qendrore, me qëllim përgatitjen për sezonin turistik 2022”.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 për “ Vetëqeverisjen Vendore“ neni 23 pika 10, bazuar në nenin 21 pika 12 të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2021 i ndryshuar, “Për menaxhimin e Integruar të mbetjeve, kontratës dypalëshe midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Operatorit sipërmarrës Alko-Impex G.C shpk me Nr.24891/11Prot datë 15.02.2022 “ Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër, zona Qëndrore”;

**URDHËROJ:**

1. Të merren masa nga operatori i ofrimit të shërbimit të pastrimit të zonës qendrore, konkretisht në lagjen 1, nga pedonale-molo-ura e vjetër e bunës –shirokë-zogaj, në shërbimin e pastrimit për përgatitjen të sezonit turistik të vitit 2022 dhe përmirësimin e performancës mjedisore të këtij territori gjatë gjithë sezonit turistik;
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës të bashkëpunojë me operatorin e ofrimit të shërbimit të pastrimit në këtë territor, në sigurimin e fuqisë punëtore për marrje masash në pastrim me qëllim përgatitjen për sezonin turistik, për angazhimin në pastrimin e territorit me intinerarin sa më sipër, me qëllimin që ti ofrohen turistëve dhe frekuentuesve të kësaj zone kushtet më të mira higjienike në pritje të sezonit turistik 2022;
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës, të hartojë dokumentacionin përkatës proceduralo-administrativ në bashkëpunim me operatorin sipërmarrës të shërbimit;
4. Për zbatimin e këtij urdhëri, ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës dhe Drejtoria e Financës.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
BARDH SPAHIA